



## Titulli i projektit

Vënia në funksionim e kanalit vaditës nga rezervuari i Letaj - Mjekërbardh (Zogaj) i komunës Bytyç

## Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

## Vendndodhja e projektit

Fshati Zogaj, Prush, komuna Bytyç

## Buxheti i paravlerësuar

8,000,000 lekë

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Në vitin 2014, ujitet vetëm 27% e sipërfaqes së mbjellë, ose 42% e sipërfaqes potenciale (në krahasim me një standard prej 70% të totalit të fondit tokës që duhet të ujitet). Komuna e Bytyçit ka rreth 15% të tokës bujqësore në zonën e Tropojës: 980 ha nga 7300 ha që ka tërë zona. Nga kjo sipërfaqe, vetëm 225 ha ose 22% e sipërfaqes ujitet. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit, si dhe lënien djerrë të tokave. Zogaj dhe Prush janë nga fshatrat që kanë sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore në komunën e Bytyçit. Vënia në funksionim e kanalit ujitës nga rezervuari i Letajt në Mjekërbardh (lagje e fshatit Zogaj) do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit bujqësor në këtë fshat dhe në komunën e Bytyçit në përgjithësi.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Rritja e prodhimit bujqësor në komunën e Bytyçit nëpërmjet rritjes së aftësisë ujtëse për tokën bujqësore në Zogaj dhe Prush.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

1. Sipërfaqja bujqësore e ujitur në Zogaj dhe Prush dhe komunën Bytyç është rritur ndjeshëm.
2. Të ardhurat e fermerëve të Zogajit dhe komunës së Bytyçit janë rritur.
3. Furnizimi me produkte bujqësore dhe blektorale për zonën funksionale Tropojë është përmirësuar.

Rreth 120 familje fermere me rreth 650 banorë do të përfitojnë nga ky projekt. Fermerët e komunës Bytyç do të përfitojnë direkt nga ky projekt. Në komunën Bytyç, që zë rreth 20% të territorit të zonës funksionale, jetojnë rreth 12% e popullsisë së zonës.



## Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Letaj-Mjekërbardh, 7 km i gjatë.
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Letaj (rezervuari) - Mjekërbardh.
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.)
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët, shoqatën e përdoruesve të ujit për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje.

Projekti realizohet për 6 muaj.

## Maturimi i projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë studim fizibiliteti, apo studim të detajuar/projekt teknik për këtë projekt. Kostoja është një paravlerësim i përafërt. Kanali vaditës ekziston, por është jashtë funksionit dhe ka nevojë për ndërhyrje (ndërtim, sistemim, përmirësim).

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e financimit mund të jenë nëpërmjet fondeve publike (të qeverisjes vendore, apo qendrore, si Ministria e Bujqësisë), apo të donatorëve të huaj që mbështesin zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

## Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është 8,000,000 lekë, përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Letaj (rezervuari) - Mjekërbardh, 7 km i gjatë (800,000 lekë).
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Letaj (rezervuari) - Mjekërbardh.
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.) (7,200,000 lekë)
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët, shoqatën e përdoruesve të ujit për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje.